



**KONTRATE SHIT – BLERJE KUOTASH  
(Shoqeria “COFFEE CLUB” shpk)**

Sot me dt. 3.07.2004 u paraqiten para meje Noter ALI TURKU personat e poshte shenuar:

- 1) **Dante Arnoldi**, I biri BRUNOS I dt. 01.01.1970 banues ne Torino, Rr. “Lancia” Nr. 66/10100 me shtetesi dhe kombesi Italiane, me Nr. Pasaporte NR355938R

Ne vijim te kesaj kontrate shit-blerje kuotash personat e mesiperm kane target e shitesve dhe ne vijim te kesaj kontrate do te cilesohet **SHITESI**.

- 2) **Shoqeria “MICO IMPORT – EXPORT TRADING & MARKETING” srl**, me seli ne Bologna, Rr. “San Mamolo” 155 CAP 40136, perfaqesuar nga ortaku dhe administratori I vetem **Trotta Stefano**, lindur ne Bologna me dt. 03.11.1966, banues ne Rr. “Edoardo Brizio” 19 CAP 40134, me shtetesi dhe kombesi Italiane, me Nr. Pasaporte Nr. 310965
- 3) **Ndrek Zaja**, I biri I Gjetes I dt.17.02.1964 me banim ne Rr.:5 Maji Tirane, me shtesi dhe kombesi Shqiptare, me Nr.pasaporte 1037632
- 4) **Zuccarino Alfonso i biri i....** i dt. 30.07.1961 me banim Rr. Duka Di Genova Nr 4547 provinca e Apriciana Fogia me shtetesi dhe kombesi Italiane me pashaporte Nr156469

Personat e mesiperm ne kete kontrate paraqiten me cilesine e bleresve te vecante te kuotave te shoqerise “COFFEE CLUB” shpk, te disponuara teresisht nga **Dante Arnoldi**, ortak dhe administrator I vetem I shoqerise.

Ne vijim te kesaj kontrate shoqeria “**MICO IMPORT – EXPORT TRADING & MARKETING” srl**, **Ndrek Gjete Zaja** dhe **Zuccarino Alfonso** do te cilesohen **BLERES**.

**OBJEKTI I KONTRATES**

Ne baze te vendimit Nr. 29016 dt.07.02.2003 te Gjykates se Rrethit Tirane, rezulton qe te jete ortak I vetem i shoqerise “COFFEE CLUB”shpk **Dante Arnoldi**.

Po mbi bazen e ketij vendimi rezulton se te gjtha kuotat e shoqerise disponohen teresisht nga **Dante Arnoldi** me kapital themelor te regjistruar 100.000 leke.

Rezulton gjithashtu qe gjendja e detyrimeve ndaj te treteve e shoqerise ne momentin e nenshkrimet te kesaj kontrate eshte pa asnje barre apo detyrim administrativ Ne keto detyrime perfshihen marredheniet me te tretet ,ipoteka , mardheniet me Tatim Taksat, sigurime shoqerore, energji elektrike, uje etj.

Ne precizim te tagreve qe ka shitesi mbi kuotat e vena ne shitje dhe te aktiveve te shoqerise (mjete xhiro, pajisje inventari etj.) qe shoqerohen me inventarin fizik mbi gjendjen e pajisjeve e makinerive, me informacionet perkatese per identifikimin e ketyre mallrave, gjendjen teknike dhe karakteristika te vecanta.

**VLERA E SHITJES, MENYRA E LIKUIDIMIT**

Shitesi shet ne menyre respektive bleresve ne keto kushte:

Ne total vlere e kontrates qe shitesi ka percaktuar ne objektin e saj pranohet nga bleresit ne shumen prej 1.000.000. leke., vlere qe e ndare ne 100 kuota pranohet qe vlere e nje kuote eshte 10.000 leke, te cilat ne menyre individuale si me poshte do te disponohen nepermjet kesaj kontrate shitje nga bleresit ne menyre individuale si vijon:

Shoqeria "MICO IMPORT - EXPORT TRADING & MARKETING" srl do te disponoje 70% te kapitalit themeltar, e barabarte kjo me 70 kuota, ne vleren respektive prej 700.000 leke.

Ndrek Zaja, do te disponoje 5% te kapitalit themeltar, e barabarte kjo me 5 kuota, ne vleren respektive prej 50.000 leke.

Zuccarino Alfonso do te disponoje 25% te kapitalit themeltar, e barabarte kjo me 25 kuota, ne vleren respektive prej 250.000 leke.

Me likuidimin e shumës shitesi *Dante Arnoldi* zhvishet nga cdo e drejte apo detyrim civil mbi sendet objekt-kontrate shit-blerje shkeput cdo mardhnie me kete shoqeri dhe te gjitha tagret e pronesise kalojne mbi bleresit, me cilesine e ortakeve te ardhshem te shoqerise.

Modalitetet e marrjes ne dorezim te te gjithë veprimtarise administrative dhe te aktivitetit tregtar te shoqerise do te behen konform rregullave administrative.

### BAZA LIGJORE, PRAKTIKA ADMINISTRATIVE

Per rregullimin e marredhenieve juridike ne kalimin e pronesise nga shitesit tek bleresit, kjo kontrate i referohet akteve themeluese te shoqerise "COFFEE CLUB" shpk (neni 10 i Statusit te shoqerise), Ligjit per shoqerite tregtare Nr. 7638 dt. 19.11.1992, Ligji 7667 dt. 28.01.1993 "Per regjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare", si dhe dispozitat e kontrates se shitjes te pasurive te luajtshme qe precizon kodi civil neni 710 e vijues i k.c.

Ne rastet e lindjes se mosmarreveshjeve dhe kur behet e pamundur zgjidhja ne mirekuptim palet kontraktuese i referohen per kopetence lendore Gjykates se Rrethit Tirane.

Si pjese perberese bashkelidhur kesaj kontrate eshte flete inventari per pajisjet, gjendja ne magazine, situacioni ne likuide, te cilat si praktike administrative lidhet me verpimtarine e shoqerise deri ne momentin e nenshkrimit te kesaj kontrate.

Kjo kontrate mbahet nga 4 kopje ne dy gjuhe ne origjinal ne gjuhen shqipe dhe Italiane dhe nenshkruhet nga bleresit pasi ju eshte perkthyer dhe jane bindur per efektet e saj juridike.

Kjo kontrate nenshkruhet para noterës, e cila verteton firmat e paleve kontraktuese ne kete kontrate shit - blerje kuotash te shoqerise "COFFEE CLUB" shpk.

### PALET KONTRAKTUESE

#### SHITESI


Dante Arnoldi

 DANTE ARNOLDI

#### BLERESIT


1. Shoqeria "MICO IMPORT - EXPORT TRADING & MARKETING" srl

Perfaqesuar


 TROTTA STEFANO

2.

Ndrek Zaja



3.



Vertetohen sa me siper firmat e paleve kontraktuese nga une noterja.



NOTER  
ALI TURKU  
